



Republika e Kosovës  
Republika Kosova –  
Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality  
of Prishtina



<b>Datë/a:</b>	04.03.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	NTP "BUCAJ"
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.03.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP "BUCAJ", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me drunje dekorativ ne hapesirat dhe parqet e qytetit te Prishtinës", me Nr. të Prok: 616 18 007 111 nxjerr:

## V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** kërkesa për ri vlerësim e parashtruar nga Operatori Ekonomik NTP "BUCAJ" sh.p.k. të dt. 30.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me drunje dekorativ ne hapesirat dhe parqet e qytetit te Prishtinës", me Nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. Brendshëm 616 18 007 111, kundër *Njoftimit për dhënie të Kontratës* te AK -së, të datës 27.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. **Vërtetohet** vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 30.03.2013.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me drunje dekorativ ne hapesirat dhe parqet e qytetit te Prishtinës", me Nr. Brendshëm 616 17 148 211 dhe mbështet njoftimin për dhënie të kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 05.02.2018 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: **"Furnizim me drunje dekorativ ne hapesirat dhe parqet e qytetit te Prishtines"**, me Nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. Brendshëm 616 18 007 111.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 07.03.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 27.03.2018, Autoriteti Kontraktues njoftuar OE lidhur me rezultatet e aktivitetit të prokurimit dhe ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Me datë 30.03.2018, Operatorit Ekonomik NTP "BUCAJ", i është lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik NTP "BUCAJ", me dt. 30.03.2018, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me drunje dekorativ ne hapesirat dhe parqet e qytetit te Prishtines"**, me Nr. 616-18-317-1-1-1 dhe Nr. Brendshëm 616 18 007 111, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK -së, të datës 30.03.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së, në të cilin theksohet:

*1) Pretendimi 1: Kompania e cila është shpalle fituese nuk posedon dhe nuk i ka prezantuar: Certifikatën Fito sanitare, Certifikatën e origjinës se mallit dhe Duda doganor sipas kërkesës se parashtruar ne Dosje te tenderit ne piken "Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe profesionale, dhe si rrjedhoje ka shkelur dispozitat e LPP, respektivisht:*

Nenin 6: Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Nenin 7: Barazia ne Trajtim

Nenin 60: Kriterin për dhënie te kontratës para 1.1, 1.2 dhe 2

Nenin 69: Aftësitë Teknike dhe profesionale para 2.1, 2.5 dhe 3

## I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

Ne lidhje me dispozitat e shkelura te LPP-se për te cilat pretendon NTP "BUCAJ", Autoriteti Kontraktues sqaron se ka bërë vlerësimin e ofertave ne përputhje te plote me Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe njëkohësisht hedhë poshtë te gjitha pretendimet e OE.

1. **Neni 6** (*Ekonomiciteti dhe Efikasiteti*) - sipas këtij neni AK është i obliguar qe te siguroj që fondet publike dhe burimet publike përdoren në mënyrën më ekonomike, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhëne asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
2. **Neni 7** (*Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*) - sipas këtij neni AK është i obliguar qe do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke trajtuar te gjithë OE ne mënyre te barabarte dhe ne te njëjtën kohe thekson se nuk keni dhëne asnjë argument se është shkelur kjo dispozite.
3. **Neni 60** (*Kriterin për dhënie te kontratës*) para 1.1, 1.2 dhe 2 – sipas këtij neni AK do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; ose 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm, gjë te cilën AK e ka respektuar, duke shpallur fitues ofertën e përgjegjshme me çmimin me te ulet, pra ka respektuar nenin 60.1.1 dhe ne te njëjtën kohe ju sqaron se AK nuk ka shkel paragrafet 1.2 dhe 2 te nenit 60 pasi qe këta dy paragraf ndërlidhen me kriterin e shpërblimit tenderi ekonomikisht me i favorshëm qe ne rastin konkret nuk është relevant.
4. **Neni 69** (*Aftësitë Teknike dhe profesionale*) – sipas nenit 59.4 te LPP, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. AK gjatë vlerësimit ka respektuar ne përpikëri ketë nen. Sa i përket kërkesës se parashtruar ne DT dhe ne Njoftim për kontratë ne lidhje me nenin 69 "Aftësitë Teknike dhe profesionale" dhe pretendimit te OE:

Kërkesa ne DT	Dëshmia Ne DT
1. Kërkesa për certifikate fito-sanitare	Certifikata fito-Sanitare
2. Operatori Ekonomik duhet të deklaroj vendin e origjinës të mallrave	Deklarata për Origjinën e Mallrave e nënshkruar dhe e vulosur nga OE

AK hedh poshtë pretendimin e OE sepse Kompania e cila është shpalle fituese:

1. Sipas kërkesës ka prezantuar *Certifikatën Fito sanitare lëshuar me datë 27.02.2018 nga Holanda*
2. Sipas kërkesës ka prezantuar *Deklaratën për Origjinën e Mallrave të nënshkruar dhe të vulosur nga OE* dhe ne të njëjtën kohë ju informojmë se Certifikata e origjinës së mallit nuk ka qenë kërkesë e kualifikimit por është kusht i kontratës sipas Aneksit 1 "Specifikimet teknike" ku ceket se "Furnizuesi për fidanët e furnizuara duhet të dëshmojë me certifikate fitosanitare dhe dëshmi për prejardhjen e tyre nga vendet e BE – së", **do të thotë OE fitues gjatë realizimit të kontratës do të prezantojë certifikatën fitosanitare për secilin furnizim.**
3. Ndërsa sa i përket *Dudit doganor*, kjo kërkesë nuk ka qenë e parashtruar në DT dhe në Njoftimin për Kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

